

74-Vjetori i themelimit të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës

I nderuari drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, z. Fazli Gajraku,

Të nderuar të pranishëm,

Kam kënaqësinë dhe nderin që sot të festojmë një vit tjetër veprimtari të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”, të reflektojmë mbi rolin e çmueshëm të këtij institucioni dhe mundësitë e përkrahjes në iniciativat që ndërmerr dhe në sfidat me të cilat përballet.

Mesazhi se bibliotekat janë unike dhe të vlefshme duhet të komunikohen me zë të lartë dhe të qartë. Ne e dimë se bibliotekat sot janë më shumë sesa thjesht libra: janë vende sociale për takime, janë shërbime njerëzore për ata që kanë nevojë për mbijetesë, janë dera e parë për të mësuar fëmijët e vegjël, janë vendi për përdorimin e internetit dhe trajnimin për të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Për tu siguruar që bibliotekat të luajnë në mënyrë efektive rolin e tyre në zhvillimin e qytetarëve të mirëinformuar përmes qasjes së lirë dhe të pakufizuar në informacion, shërbimi duhet të financohet dhe drejtohet në mënyrë adekuate nga profesionistë të trajnuar me mbështetjen e personelit të duhur. Vetëm nëpërmjet stafit të trajnuar profesional, mund të sigurohen standardet e përmirësuar të shkrim-leximit dhe angazhimit demokratik që janë themeli i një shoqërie të begatë të shekullit 21.

Bibliotekës i duhen rritur kapacitetet e punonjësve ekspertë të bibliotekarisë, të arsimuar në këtë fushë, të zotë për të përfutur dhe për të dhënë nga dijet bibliotekare. Përkrahësit e bibliotekave presin që njerëzit që bibliotekat punësojnë do të jenë zëri i tyre në luftën për shërbimin më të mirë bibliotekar për komunitetin e tyre.

Është e pashmangshme që digjitalizimi i vazhdueshëm i kulturës do të çojë në një integrim gjithnjë e më të madh të institucioneve kulturore dhe bibliotekare që do të zhvendosen nga vendet e librit në vende të kujdesës sonë të trashëgiminë kulturore dhe intelektuale. Bibliotekat kështu do të bëhen institucione të kujtesës si galeritë e artit dhe muzetë. Kjo sigurisht do të thotë se roli i bibliotekarëve do të ndryshojë. Ideja e bibliotekës profesionale do të zhduket dhe në vend të saj do të dalë ideja e kuratorëve profesionistë informativë dhe kulturorë dhe kjo do të përqafojë një shumëllojshmëri të shkathtësive të ndryshme.

Megjithatë, në këtë kohë, përveç të tjerash, po vazhdon përpjekja dhe angazhimi në ngritjen e profilit të bibliotekës duke mëtuar të krijohet një besim për këtë institucion, për punën e vlefshme të tij.

Qeveria e Kosovës, drejtpërdrejtë apo nëpërmjet dikastereve të saj do të vazhdojë ta përkrahë zhvillimin e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës dhe të bibliotekave në përgjithësi, ashtu siç edhe ka përkrahur shumë projekte për Bibliotekën, për librin e për kulturën në përgjithësi.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, tashmë është e përkushtuar në mbështetjen për realizimin e fazës së dytë të projektit “Kujtesa e Kosovës – Rrëfime nga 100 pleq e plaka” që ka grumbulluar 100 intervista të të moshuarve mbi 80 vjeç për të pasuruar historinë e shkruar të Kosovës të shekullit të fundit.

Gjithashtu, kemi përkrahur edhe një ndër projektet më madhore të Bibliotekës Kombëtare, projekti “Bibliografia e librit shqip”, e cila do të përfshijë përshkrimin bibliografik të secilit titull shqip të botuar që nga viti 1912 deri në vitin 1999, projekt ky që do të çojë përpara një nga rolet kyçe të fushës së bibliotekarisë.

Për të rritur më tutje kapacitetin e shërbimeve të Bibliotekës Kombëtare, ne kemi mbështetur sigurimin e klimakomorëve që kanë mundësuar kushte të favorshme për shfytëzimin e hapësirave të bibliotekës nga lexuesi. Kushtet infrastrukturore aktuale të Bibliotekës Kombëtare kërkojnë vëmendje të shtuar nga institucionet legjislative për të siguruar mbarëvajtjen e duhur të veprimtarisë së bibliotekës si dhe konservimin e materialit që grumbullohet.

Investimet që ne bëjmë dhe mbështesim për bibliotekën, gjithmonë shpaguhen me rolin që ato luajnë për edukimin dhe të ardhmen e komunitetit tonë.

Sot, themelimi i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës në vitin 1944, mund të perceptohet si një nga ngjarjet më të rëndësishme të kulturës shqiptare të Kosovës. Ky institucion qendror bibliotekar kryen veprimtarinë e vet sipas legjislacionit shtetëror të shtetit të Kosovës dhe historikisht, gjatë këtyre 74 viteve, vazhdon të grumbullojë dhe të ruajë më masivisht dhe denjësisht kulturën dhe trashëgiminë e këtij shteti.

Unë shfrytëzoj rastin të falënderoj stafin e Bibliotekës Kombëtare për punën që ka bërë gjatë këtij viti dhe për përkujdesjen më të madhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve të bibliotekës.

Gjithashtu, në 74-Vjetorin e themelimit të Bibliotekës Kombëtare, përgëzoj edhe Shoqatën e ish të Burgosurve Politikë të Kosovës për organizimin e ekspozitës me fotografi që pasqyrojnë një ngjarje historike të shtetit tonë – atë të demonstratave të vitit 1968, duke kontribuar kështu në njohjen e ngjarjeve dhe datave historike të popullit nga publiku dhe lexuesi dhe në pasurimin e trashëgimisë kulturore të popullit tonë.

Ju uroj të gjithëve suksese në veprimtaritë e radhës!